

VENDIM
Nr.627, datë 23.9.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.603, DATË 8.9.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR RREGULLAT DHE VEPRIMET E ZYRAVE TË GJENDJES CIVILE,
PËR TRANSFERIMIN E TË DHËNAVE TË GJENDJES CIVILE TË SHTETASVE, TË
REGJISTRUAR NË REGJISTRIN E PËRKOHSHËM”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1, 5 e 7 të nenit 12 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 5 e vendimit nr.603, datë 8.9.2006 të Këshillit të Ministrave ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Për të ndihmuar dhe monitoruar procesin, në zyrat e gjendjes civile të bashkive, të njësive bashkiake të Tiranës apo të komunave me mbi 1000 shtetas në regjistrin e përkohshëm, prefekti cakton një person, me arsim të lartë dhe banues në njësinë e qeverisjes vendore përkatëse, i cili duhet të vrojtojë gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të këtij procesi. Caktimi i personit për vrojtimin e procesit të bëhet sipas rregullit të mëposhtëm:

Partia më e madhe në opozitë, me kryetarin e bashkisë/komunës ose të njësisë bashkiake për Tiranën, i propozon prefektit personin përgjegjës. Prefekti bën emërimin, sipas propozimeve të partive, jo më vonë se 24 orë nga propozimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha